



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Kuvendi i Kryeqytetit - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT

i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Barazi Gjinore, mbajtur më 29.3.2023, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Violeta Salihu, Besart Krasniqi, Leonora Shabani - Bajraktari, Dhurata Jahaj - Retkoceri dhe Gëzim Mehmeti.

E pranishme ishte edhe Premtime Preniqi, koordinatorë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Violeta Salihu**, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

Rend të ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë;
2. Diskutim nga udhëheqësi i Burimeve njerëzore rreth punësimit dhe avancimit të vajzave dhe grave gjatë vitit 2022 në Komunën e Prishtinës;
3. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Barazi Gjinore

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Barazi Gjinore.

Pika dytë

Diskutim nga udhëheqësi i Burimeve Njerëzore rreth punësimit dhe avancimit të vajzave dhe grave gjatë vitit 2022 në Komunën e Prishtinës

Violeta Salihu, kryesuese tha se për këtë mbledhje ka qenë e paraparë që të jetë prezent udhëheqësi i Burimeve njerëzore, për të na njoftuar rreth punësimit dhe avancimit të vajzave dhe grave gjatë vitit 2022, por ai nuk iu ka përgjigj ftesës time. Ne si komitet do të ishte mirë që të informohemi rreth asaj se më herët çka ka ndodhë, çka

ka bërë kjo qeverisje p.sh në vitin 2022 sa gra-vajza ka punësuar, si i ka avancuar në pozita, pra me pa a është përmirësuar në krahasim me vitet e tjera, tash secilën herë po ka përmirësime, por meqë nuk kemi informacione, ne nuk dimë qysh ka ndodhë.

Premtime Preniqi tha se sipas informatave që ne i kemi veç brenda në Komunë kanë qenë gati thujse 50 me 50, pa shëndetësi dhe arsim, pra veç drejtoritë e Komunës pa institucionet përcjellëse, mirëpo faktikisht ka qenë problemi i pozitave vendimmarrëse. Në pozita vendimmarrëse, drejtoritë janë veç në nivelin politik, ato veç zgjedhën në aspektin politik. Këtë mandat janë të formuara gjithsejtë 17 drejtori, prapë nuk është 50 me 50, por në krahasim me vitet që kemi pasur 2-3 drejtori, prapë nuk jemi keq në këtë mandat, me shefe jemi më keq, është numër më i vogël.

Violeta Salihu, kryesuese tha se po formohen drejtoritë, po japin premtime, por normal se duhet me u zotë që gjysma me qenë gra dhe vajza, mirëpo për të punësuarat në Komunë, s' di qysh kemi me pas ne një mekanizëm më gjet sa janë avancuar.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se sa i përket pozitave që secila pozitë që është udhëheqëse, vërtetë duhet me pas vetëm një mandat, p.sh. në Shkollën Speciale që 20 vjet është e njëjta drejtore, po ashtu edhe në shkollën e të verbërve "Lef Nosi" në Prizren po thujse i njëjti rast, kështu që duhet edhe të tjerëve t'iu jepet mundësia të jenë në pozitat udhëheqëse, jo vetëm një person me vite të tëra.

Gëzim Mehmeti tha se kur kemi qenë ne në pushtet si AKR, problemi kryesor ka qenë me sekretarët e ministrive, sepse sekretarët e ministrive kanë qenë bosët e ministrive, kurse ministrat kanë qenë thujse kalues. Një parti i ka kontrolluar sekretarët dhe e ka bllokuar çdo proces, çdo iniciativë, çdo program që e ka pas ministri apo ministrja e ka bllokuar, pra ata kanë qenë si zot dhe kjo hapësirë u është dhënë me qëllim performance për gjithë at mandat. Po ashtu sa isha drejtor në drejtorinë komunale, gjinia femërore hezitonin me marrë pozitën për tu bërë shefe, sepse natyra e punës, kërcënimet, jashtë orarit të punës me i kontrolluar punët ka qenë shumë e vështirë dhe ato nuk donin ta kenë atë përgjegjësi, se është përgjegjësi e madhe.

Violeta Salihu, kryesuese tha se tani pasi që veç e kemi formuar Grupin e grave asambliste do të ishte mirë që të marrim ndonjë iniciativë për me bërë diçka që veç e kemi nisur, tash veç kryesuese të grupit e kemi Dhuratën, dhe deri më tani ne i kemi pasur disa tentativa, kështu që është mirë tash ne me bë diçka me ata që e kemi nisë.

Leonora Shabani-Bajraktari tha se, pasi që ende është fillimi i mandatit për asamble, kisha propozuar që gratë të cilat janë në asambleenë komunale përmes UN Women me ofruar sa më shumë trajnime, sidomos për buxhetimin e përgjithshëm gjinor.

Dhurata Jahaj-Retkoceri tha se sa i përket trajnimeve të ndryshme rreth kësaj fushe, mendoj se ato trajnime 1 ditore nuk dijnë se çka mund të ofrojnë edhe aq shumë, kështu që kur nuk ke eksperiencë, atë informatë brenda 1 ose 2 dite nuk mundesh me e marrë.

Gëzim Mehmeti tha se Grupi i grave duhet të jetë më aktiv në realizimin e qëllimeve që ka grupi, kështu që tash në muajin prill, apo në gusht e kemi prapë çështjen e propozimit të buxhetit, nëse jeni aktiv bëni presion te ekzekutivi, pra vetëm kështu mundeni me funksionuar.

Leunora Shabani -Bajraktari tha se, unë çdo herë e kam iniciuar me e krijuar grupi, mandej normal kryesuesja e grupit me u marrë me ato çështje tjera dhe ka vazhduar, pra i vetmi mandat që ka funksionuar grupi i grave ka qenë kur ka qenë kryesuese znj. Kimet Zeqa, e cila për tërë kohën sa ishte kryesuese ka organizuar shumë aktivitete.

Violeta Salihu tha se do të ishte mirë që ne me arritë me e bërë një trajnim jashtë ose një udhëtim studimor, por me rëndësi me bërë diçka që me e ngjallë një aktivizim. kështu që ne jemi të gatshme ti ndihmojmë Dhuratës çka do që ajo e merr ndonjë iniciativë me grupin e grave asambliste.

Mbledhja përfundoi në orën 17:15

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

